

Z Bujar Leskaj
Kryetar
Kontrolli i Lartë i Shtetit
Bulevardi "Dëshmorët
e Kombit" Tiranë

Qershor 2013 Nr. 11-5.1/13/6,9,

Takimi i 15të i Grupit të Punës së INTOSAI-t për Auditimet e Mjedisit

I nderuar Z. Bujar Leskaj

Dëshiroj t'Ju falenderoj juve personalisht si dhe stafin tuaj për kontributin e dhënë në zhvillimin me sukses të takimit të 15-të të Grupit të Punës së INTOSAI-t për Auditimet e Mjedisit, të zhvilluar në Talin, Estoni në datat 3-6 qershor 2013.

Zyra Kombëtare e Auditimit të Estonisë, pati kënaqësinë të priste 158 delegatë nga 70 institucione supreme të auditimit dhe disa organizata ndërkombëtare, gjatë takimit të 15-të të këtij Grupi Pune. Asnjëherë më parë, nuk ishin mbledhur kaq shumë SAI në një takim të këtij Grupi Pune. Gjithashtu, 15 Kryetarë SAI-sh ishin prezent, një përgëzim për Grupin e Punës si dhe një provë e fortë për rritjen e rëndësisë lidhur me çështjet e mjedisit për komunitetin auditues.

Shpërndarja e eksperiencave dhe njohurive, është një nga bazat e asambleve të INTOSAI/ WGEA. Ky takim, nuk bëri përjashtim lidhur me këtë fakt. Përkundrazi: stafi ynë mori 34 auditime mjedisi, bashkë me prezantimet përkatëse. Përafërsisht 30 SAI paraqitën eksperiencat e tyre më të fundit të auditimit në seancat plenare paralele të takimit.

Ato SAI, të cilat kanë ndërmarrë zhvillime lidhur me udhëzuesit dhe materiale të auditimeve të mjedisit, si dhe studime kërkimore për periudhën 2011-2013, organizuan sesione paralele ku pjesëmarrësit morën informacione kyçe nga përfaqësues dinjitozë të Estonisë, përfaqësues të Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin, ECA, Fondacioni kanadez për Kërkimin dhe Arsimimin CCAF-FCVI, Zyra e Audituesit të Përgjithshëm të Kebekut. U thirr një panel ekspertësh, që përfshinte edhe përfaqësues të SAI-ve me mjaft eksperiencë, për të reflektuar trendet dhe zhvillimet e viteve të fundit në auditimet mjedisore, si edhe ato të së ardhmes.

Asamblesë së 15-të, iu caktuan edhe detyra të rëndësishme lidhur me funksionimin e grupit të punës, duke miratuar dokumenta të Grupit të Punës për Auditimet e Mjedisit të përmbushura gjatë 2011-2013, si edhe hartimin e planit të punës për periudhën 2014-2016, gjatë kryesisë së Bordit të Auditimit të Republikës së Indonezisë pas Kongresit të XXI të INCOSAI-t, në tetor 2013.

Asambleja miratoi dukumentet e INTOSAI/WGEA si vijon:

- *Çështjet lidhur me Mashtrimin dhe Korrupsionin kur Auditohet Menaxhimi Mjedisor dhe Burimet Natyrore: Udhëzues për Institucionet Supreme të Auditimit*
- *Auditimi i Çështjeve të Ujit: Një Ekzaminim i Eksperiencave të SAI-ve dhe Mjeteve Metodologjike që ata kanë përdorur me sukses;*
- *Raportimi i Qëndrueshëm, Koncepte, Strukturat dhe Roli i SAI-ve;*
- *Impakti i Turizmit në Ruajtjen e Faunës së Egër;*
- *Çështjet mjedisore që lidhen me Zhvillimin e Infrastrukturës;*
- *Të dhënat Mjedisore: Burimet dhe Opsionet për SAI-t;*
- *Përdorimi i Tokës dhe Praktikave të Menaxhimit të Tokës në Perspektivën mjedisore.*

Asambleja miratoi gjithashtu planin e ri të punës të WGEA-s për 2011-2013 dhe SAI-t firmosën për projektet e ardhshme të studimit. Të gjithë drejtuesit e rinj të projekteve dhe anëtarët e nën-grupeve, janë të mirëpritur dhe të ftuar të konfirmojnë angazhimet e tyre, nëse konsiderohet e nevojshme nga institucionet respektive.

Për t'u njohur me materialet e takimit të 15-të të Grupit të Punës, duke përfshirë edhe prezantimet, përmbledhjen e materialeve të seminareve dhe galerinë fotografike, referohuni në faqen e internetit www.environmental-auditing.org. Zbardhja e takimit do të bëhet e mundur në momentin e duhur dhe do të njoftohet nëpërmjet e-mailit.

Ju falenderoj për mbështetjen dhe bashkëpunimin Tuaj dhe pres me padurim të takohemi në Pekin, në tetor



Alar Karis
Kryetar i INTOSAI WGEA Auditor i Përgjithshëm
Zyra Kombëtare e Auditimit të Estonisë